



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Mbledhja nr. 80

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

Prishtinë, më 21 tetor 2013, në orën 11:00

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Fikrim Damka, Time Kadrijaj, Flora Brovina, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi, Nazane Breca dhe Bahri Thaçi.

Munguan: Liburn Aliu dhe Sasha Gjokiq.

Të pranishëm: Shpresa Haxhijaj, koordinatorë e Komisionit, Xheneta Sopjani, praktikante.

Mbledhjen e kryesoi, Fikrim Damka, kryetar i Komisionit

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.09.2013;**
- 3. Raportimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 25.09.2013

Komisioni miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 25.09.2013

3. Raportimi i grupeve punuese për Projektligjet në procedurë

Fikrim Damka - Tha se në procedurë i kemi disa projektligje, dy prej tyre janë proceduar te komisionet kryesore, por që ende nuk kemi përgjigje nga Komisioni për Buxhet dhe Komisioni për Komunitete. Mjaft shumë është vonuar Projektligji për skemat pensionale të financuara nga shteti. Ndoshta duhet t'i drejtohem me një shkresë Komisionit për Buxhet që të kemi një përgjigje për këtë Projektligj. Sa i përket Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile të luftës dhe familjeve të tyre, Komisioni për komunitete kanë vërejtje për disa amendamente dhe kanë kërkuar të shkojmë të diskutojmë në Komision për këto amendamente, por ende nuk kemi ftesë zyrtare.

Një shkresë për këtë Projektligj e kemi marrë edhe nga Zyra e Unionit Evropian në Kosovë ku sugjerojnë që Projektligji të plotësohet me dy propozime. Propozimi i parë ka të bëjë me termin "person i dhunuar gjatë luftës" të zëvendësohet me termin „ viktimat të dhunës seksuale të lidhur me luftën", dhe propozimi i dytë është që përkufizimi „ **person i dhunuar gjatë luftës** – person i cili i ka mbijetuar abuzimit seksual dhe dhunimit brenda periudhës së 27.02.1998 deri më 20.06.1999, të shtyhet periudha e propozuar kohore gjer në fund të vitit 2000.

Mendoj se duhet t'i presim komentet prej të gjitha komisioneve kryesore, e pastaj të shqyrtojmë edhe njëherë Projektligjin dhe komentet e Zyrës së Unionit Evropian. E hapi diskutimin.

Time Kadrijaj – Tha se pajtohem që këto komente të Zyrës së Unionit Evropian në Kosovë t'i shqyrtojmë së bashku edhe me komentet e komisioneve të tjera.

Flora Brovina – Tha se fillimisht ndoshta do jetë më mirë që të kemi një takim të përbashkët Komisioni jonë me Komisionin për komunitete dhe t'i sqarojmë amendamentet e propozuara nga Komisioni ynë. Termi i përdorur si okupator serb është i vërtetë, dhe ashtu ka ndodhur, nuk mund ta quajmë ndryshe. Megjithatë t'i presim komentet me shkrim.

Sa i përket shkresës së Zyrës së Unionit Evropian në Kosovë, nuk pajtohem sidomos me komentin e dytë, por megjithatë ta shqyrtojmë bashkë me komentet e komisioneve të tjera në një mbledhje të veçantë.

Bahri Thaçi – Tha se sugjerimi i propozuar për ndërrimin e termit „ viktimat seksuale të lidhura me luftën" nuk mund të qëndroj si i tillë, pasi ato janë viktimat civile të dhunës seksuale gjatë luftës, e jo të lidhura me luftën.

Nazane Breca – Tha se duhet shikuar si është në Projektligj përkufizimi i personave të dhunuar gjatë luftës.

Flora Brovina – Tha se patjetër duhet të takohemi me z. Samuel Žbogar dhe të sqarohemi rreth këtyre propozimeve.

Pas diskutimeve Komisioni vendosi që pas pranimit të raporteve nga Komisionet kryesore të diskutohet prapë Projektligji dhe komentet e Zyrës së Unionit Evropian në Kosovë.

Sa u përket Projektligjeve të tjera në procedurë, u vendos që të vazhdojë puna e grupeve punuese, që sa më shpejt të përfundohen këto projektligje.

Salihe Mustafa – Tha se grupi punues që është duke shqyrtuar Projektligjin për transplantimin e indeve dhe qelizave, është duke punuar dhe se mendoj se nuk ka nevojë të ngutemi, por ta bëjmë një Projektligj sa më të mirë.

Time Kadrijaj – Tha se Projektligji për agjencinë e punësimit, shumë shpejt do të përfundohet dhe javën e ardhshme mund të jetë në rendin e ditës në Komision.

Fikrim Damka – Tha se puna e grupit punues në Projektligji për produkte dhe pajisje medicinale do të vazhdojë javën e ardhshme.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit

Fikrim Damka